



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P- 117  
Prishtinë, më 2 maj 2013

**PROCESVERBAL**

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 2 MAJ 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaqi, Hykmete Bajrami, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Zenun Pajaziti, Haki Demolli, Albin Kurti, Rexhep Selimi, Bekim Haxhiu dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Ganimete Musliu parashtrroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me atë se pse studentët, të cilët i kanë mbaruar studimet me sistem katërvjeçar, me 42 provime, kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të Jurisprudencës, pa i mbaruar studimet master, ndërsa studentët me sistem trevjeçar, me 45 provime, nuk kanë të drejtë t'i nënshtrohen këtij provimi pa i mbaruar studimet master.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputeti Arsim Bajrami parashtrroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me atë se cilat veprime po i ndërmerr ministria që ai drejton për mbikëqyrjen e standardeve të mësimdhënies dhe kuadrit në universitetet e sapoformuara publike.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Arsim Bajrami.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se a është në dijeni ministria që ai drejton për faktin e kultivimit të grurit në vendin e quajtur fusha e palosjes së hirit të KEK-ut, që shtrihet ndërmjet fshatrave Orllloviq, Dardhishtë dhe Dragodan, e cila nga ekspertët konsiderohet se është e kontaminuar për shkak të pranisë së metaleve të rënda dhe cilat masa janë ndërmarrë apo do të ndërmerren lidhur me këtë çështje. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me atë se kur do të vazhdojë puna e lënë në gjysmë lidhur me projektet e rrugëve magjistrale Prishtinë-Mitrovicë dhe Prishtinë-Pejë dhe a pritet përfundimi i punimeve këtë vit, në raport me mjetet e ndara për këto dy projekte. Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputeti Hashim Deshishku parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me zhvillimet e deritanishme në autostradën “Ibrahim Rugova”, për paratë e investuara dhe kilometrat e përfunduara, standardin e ndërtimit në segmentin Gjurgjicë-Vragoli dhe për arsyen e ndryshimit të trasesë së kësaj autostrade për Merdar apo për Mutivodë. Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Hashim Deshishku.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me masat e ndërmarra nga ministria që ai drejton pas kapjes së dy të dyshuarve, agjentë serbë, shtetas të Kosovës, të cilët kanë pranuar se kanë bërë fotografi rreth objekteve të FSK-së në Gjilan dhe rreth ruajtjes së sekretit të FSK-së, e cila pretendon të bëhet ushtri e Kosovës, si dhe a ka pasur raste të tjera të ngjashme, kur kanë rrjedhur informata mbi FSK-në. Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Halit Krasniqi parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me domosdoshmërinë e hapjes së nënkalimit në fshatin Zajm të Klinës, i cili është jetik për banorët e këtij vendbanimi. Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputeti Liburn Aliu parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se cilat asete do të kalojnë në pronësi të konsorciumit “Çalik&Limak”, si rrjedhojë e procesit të privatizimit të kompanisë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Liburn Aliu.

Deputeti Albin Kurti parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me indiferencën e ministrit lidhur me prejardhjen dhe përbërjen e kapitalit të blerësve të PTK-së - kompanisë AXOS, si dhe identitetin e kësaj kompanie. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Albin Kurti.

Deputeti Albin Kurti parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se a mendoni që si ministër i Zhvillimit Ekonomik jeni i painformuar për procesin e privatizimit të Telekomit të Kosovës. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Albin Kurti.

Deputeti Visar Ymeri parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se çfarë garancish keni marrë nga Gjermania, SHBA-të dhe Britania e Madhe dhe në çfarë forme kanë garantuar ato lidhur me privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se kush janë aksionarët, të cilët qëndrojnë prapa konsorciumit “AXOS Capital” dhe “Najafi Companies LLC”.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

### **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme**

Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 25 prill 2013 pa asnjë vërejtje.

\* \* \*

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

#### **Rend dite**

4. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatinë,
7. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, sipas kërkesës së deputetit Burim Ramadani, mbështetur edhe nga 7 deputetë tjerë lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
12. Emërimi i dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

### **4. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete**

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët se deputeti Enis Kervan e ka liruar pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, pas kërkesave të deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë. Ai i njoftoi deputetët për marrëveshjen e Grupit Parlamentar “6+”, të datës 28 mars 2013, për caktimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komuniteteve tjera, që nuk janë shumicë dhe joserbe, e cila ka paraparë zgjedhjen e nënkryetarit me rotacion.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim marrëveshjen e deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,  
Kundër ----- 6,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Rasim DEMIRI** zgjidhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë dhe joserb, për periudhën prej 1 prill deri më 30 shtator 2013.

**II.** Në bazë të marrëveshjes së Grupit Parlamentar “6+” , datë 28 mars 2013, për caktimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komuniteteve tjera, që nuk janë shumicë dhe joserb, pas mandatit të z. Rasim Demiri, për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rotacion zgjidhen deputetët, si në vijim:

1. Deputeti Albert Kinolli, prej 1.10.2013 deri më 30.4.2014, nga komuniteti rom,
2. Deputeti Etem Arifi, prej 1.5.2014 deri më 30.9.2014, nga komuniteti ashkali.

### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës jashtë vendit**

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës jashtë vendit.

Deputeti Ahmet Isufi, në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, e arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Më pas, kryesuesi i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10, 11,12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64 ,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës jashtë vendit.

### **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatinë**

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për Avokatinë.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, e arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Ai propozoi që amendamenti nr. 11 të hiqet.

Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Arben Gashi për heqjen e amendamentit 11.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Albulena Haxhiu, Arben Gashi dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryesuesi i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,  
Kundër ----- 9,  
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Avokatinë.

### **7. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, sipas kërkesës së deputetit Burim Ramadani, mbështetur edhe nga 7 deputetë tjerë lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputeti Burim Ramadani, mbështetur edhe nga 7 deputetë tjerë, ka parashtruar kërkesë për interpelancë me ministrin Ramë Buja lidhur me çështjen e përdorimit të drogave në shkollat fillore dhe të mesme.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti **Burim Ramadani**, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, tha se kjo nuk është hera e parë që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës po e ngre këtë çështje në këtë Kuvend si shqetësim jashtëzakonisht serioz me nivelin e lartë dhe tejet dëmtes të shpërndarjes dhe përdorimit të drogave nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës.

Është evidente se mungojnë statistikat e plota nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa statistikat e nxjerra nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të cilat e trajtojnë profesionalisht çështjen e varshmërisë nga drogat flasin se rreth 20% e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme përdorin lloje të ndryshme të drogave, kryesisht atyre të lehta.

Derisa mariuhana shpërndahet në shumicën e lokaleve, rreth shkollave fillore dhe të mesme, nxënësit largohen nga shkolla për shkak të mungesave që i bëjnë në mësim, e jo për shkak të përdorimit të drogave dhe jo për shkak të mundësisë së trajtimit të tyre. Kjo është detyrë e përbashkët e Ministrisë së Arsimit dhe e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në vazhdim, ai u fokusua në disa çështje lidhur me këtë problematikë, me theks në faktin se mësimdhënësit tanë nuk janë trajnuar për çështjen e drogave, nuk ka institut kombëtar për trajtimin e sëmundjes së varshmërisë në Kosovë, për mosveprimin e Qeverisë së Kosovës, për mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërsektorial brenda Qeverisë së Kosovës,

sidomos ajo që njihet si trekëndëshi kryesor, që është Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Më pas, ai theksoi se qëllimi i kësaj interpelance është që ta nxisim Qeverinë e Kosovës që të veprojë shpejt kundër kësaj dukurie negative. Objektivi ynë si subjekt politik është që ta adresojmë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike në paktën katër fusha bazë, siç janë: përballimi i problemit, zbatimi i ligjit, parandalimi, trajtimi i zvogëlimi i dëmit nga përdorimi i drogave dhe edukimi.

Ai shfaqti bindjen se me këto veprime nuk do të lejohej që droga të shtrihej edhe më shumë nëpër shkolla. Mesazhi ynë, që besoj duhet të dalë edhe prej kësaj seance, është që t'u drejtohem të rinjve, fëmijëve, që mos të mashtrohen nga një gëzim i momentit se mund t'i sjellë një dozë droge ose një dozë substancë narkotike, por të mendojnë më gjatë, të mendojnë për jetën e tyre, sepse kjo ua shkatërron të ardhmen atyre.

Në fund, deputeti Burim Ramadani i paraqiti para Kuvendit pesë pikat e mocionit, të cilat grupi i deputetëve nënshkruet i ka propozuar për këtë interpelancë.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë buja, që ta marrë fjalën.

Ministri **Ramë Buja** fillimisht tha se kjo çështje nuk i përket vetëm Ministrisë së Arsimit, por u përket edhe ministrive të tjera dhe Qeverisë, përgjithësisht.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë po angazhohet që Kosova të jetë një shoqëri demokratike e integruar në rrjedhat evropiane, që ofron kushte dhe mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë qytetarëve, ku qasja në përfitim të dijës mundësohet për të gjithë të interesuarit dhe në funksion të zhvillimit të përsheptuar dhe të qëndrueshëm.

Me qëllim të shtimit të efikasitetit për zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 dhe njëkohësisht duke marrë parasysh problemet me të cilat është ballafaquar arsimi në të kaluarën, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë po angazhohet ta përkrahë dhe ta promovojë arsimin cilësor për të gjithë, duke filluar nga edukimi parafillor, arsimi parauniversitar, arsimi dhe aftësimi profesional, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, arsimi i lartë, arsimi dhe aftësimi i të rriturve dhe teknologjia e informimit.

Në vazhdim, ministri theksoi se Ministria që ai udhëheq, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme e ka aprovuar strategjinë kombëtare për programin 'Shkollat Promovuese të Shëndetit, 2009-2018' dhe Planin e Veprimit, 2009-2013. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë pjesë e grupit punues në hartimin e Strategjisë kombëtare kundër drogave 2009-2012 dhe 2012-2017, ku merr pjesë nëpërmjet programeve të rregullta, duke i realizuar objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, në të cilat aktivitete mund të kyçen prindërit dhe komuniteti në përgjithësi, si dhe e ka hartuar Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë, 2011-2016.

Më pas, ai theksoi se në maj të vitit 2010 është realizuar trajnimi i mësimdhënësve në qasjen e shkollave promovuese të shëndetit në bashkëpunim me ekspertë të rrjetit evropian, duke u bazuar në përvojat e vendeve më të avancuara të Evropës, ku janë trajnuar 60 mësimdhënës të të gjitha niveleve për temat e edukimit shëndetësor, përfshirë këtu edhe temat mbi drogën. Mësimdhënësve u është shpërndarë materiali në gjuhën shqipe dhe në gjuhë tjera të

komuniteteve, e që këta mësime do t'i jetësojnë përvojat e tyre të marra në këtë trajnim nëpërmjet zbatimit të këtyre temave në kuadër të biologjisë, edukatës qytetare dhe lëndës zgjedhore në kuadër të mësimit klasor që ata e bëjnë.

MASHT-i, i përkrahur nga UNICEF-i, e ka zbatuar lëndën zgjedhore "Aftësitë për jetën" në shkollat fillore, klasa VIII. Brenda këtij materiali, një modul i veçantë trajton temat për shëndetin, me theks të veçantë dukuritë negative, siç është droga.

Korniza e kurrikulës, e nënshkruar në shtator të vitit 2011, është dokument bazë i arsimit, rezultat i punës së agjencive të ndryshme në fushën e arsimit dhe përcakton fushat e reja mësimore, ku një prej tyre është edhe shëndeti dhe mirëqenia.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, po ashtu në bashkëpunim me Policinë e komunitetit në bashkësi, e ka miratuar kërkesën për projektin në parandalimin e përdorimit të substancave narkotike në institucionet shkollore.

Mbajtja e ligjëratave për pasojat e drogës është realizuar nga zyrtarë kompetentë, kur ekspertë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale i kanë realizuar këto informacione dhe informata me nxënës në kuadër të orës së biologjisë. Në këtë projekt janë përfshirë nxënësit e klasave të dhjeta.

Drejtorja e Policisë në bashkësi dhe preventivë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, me pëlqimin dhe mbështetjen MASHT-it vazhdon ta zbatojë projektin "Thuaju jo substancave narkotike", ku janë përfshirë nxënësit e shkollave të mesme, klasat e dhjeta, të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta, si dhe shkollat fillore të të gjitha rajoneve. Projekti realizohet në organizimin dhe mbajtjen e ligjëratave në aspektin edukues.

Në fund, ai foli edhe për bashkëpunimin e ministrisë që ai drejton me organizatat joqeveritare në realizimin e projekteve të ndryshme, që kanë për qëllim promovimin e sjelljeve të shëndosha të rinjtë, trajnimin e 200 edukatorëve nga të gjitha komunat e Kosovës, ndërsa përmendi nënshkrimin e një marrëveshjeje me një institucion kroat, që është një projekt që do të realizojë mundësinë e bashkëpunimit nxënës-prindër, i cili ka për qëllim që për të gjitha ato që ndodhin në shkollë t'i mundësohet prindit të jetë i njoftuar.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e ministrit Ramë Buja.

**Idriz Vehapi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se tema e ngrehur është shqetësuese për ne si shoqëri, ndërsa duke pasur parasysh faktin se fati i një popullit është i lidhur ngushtë me nivelin e arsimit, ky konstatim na obligon të gjithëve si shoqëri, pa dallim, që arsimi të ketë trajtim të veçantë në të gjitha aspektet.

Në vazhdim, ai foli për hapat e Qeverisë, sidomos nga viti 2008, që përherë e kanë pasur synim trajtimin e dinjitetshëm të arsimit në të gjitha aspektet, duke i përmendur godinat shkollore, ambientet e rregulluara, librat gratis, licencimin e mësimeve, akreditimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, infrastrukturën ligjore në frymën e BE-së, kurrikulën e re dhe përmirësimin e arsimit profesional.

Për ta pasur një arsim sa më cilësor janë hartuar dokumente të rëndësishme, si: strategjia për zhvillim të arsimit parauniversitar 2007-2017, strategjia për arsim të lartë 2005-2015, si dhe plani strategjik për zhvillim të arsimit të Kosovës, 2011-2016.

Më pas, ai e vlerësoi punën që është duke u zhvilluar edhe në parandalimin e dukurive negative nëpër shkolla, sidomos kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe dukuri të tjera. MASHT-i e ka sanksionuar dhunën dhe dukuritë tjera negative me infrastrukturën e vet ligjore, duke e përputhur atë me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe me instrumentet tjera ndërkombëtare, që lidhen me të drejtat e njeriut, si dhe përmendi një mori aktesh ligjore dhe nënligjore nga fusha e arsimit.

Në fund, ai theksoi se arsimi nuk është çështje vetëm e Ministrisë së Arsimit, por është e tërë shoqërisë kosovare, andaj edhe e secilit prej nesh.

Ne si grup parlamentar do t'i përkrahim të gjitha veprimet, të cilat çojnë në parandalimin, eliminimin dhe çrrënjosjen e të gjitha dukurive negative në shkolla dhe kudo në shoqëri dhe sidomos të kësaj dukurie, tha deputeti Idriz Vehapi.

**Salih Morina**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se dukuritë negative, si përdorimi i drogave në shkollat tona viteve të fundit kanë shënuar rritje shqetësuese, gjë që dëshmohet me raportimet e rasteve të shumta në pjesë të ndryshme të vendit dhe në radhë të parë në vendet urbane.

Grupi Parlamentar që ai përfaqëson konsideron se Qeveria nuk ka bërë asgjë të rëndësishme për parandalimin e dukurive të tilla, përpos një akti simbolik të nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Punëve të Brendshme, të bërë disa vjet më parë dhe se nuk kemi parë asnjë formë të adresimit të këtij problemi.

Përdorimi i drogave në sistemin shkollor parauniversitar në Kosovë, rritja e shkallës së përdorimit çdo ditë e më shumë, është një dështim i sistemit, i Qeverisë dhe i shoqërisë sonë në përgjithësi, meqë përdoruesit janë nxënësit dhe fëmijët tanë. Po ashtu, konsiderojmë se Ministria e Shëndetësisë është dashur ta japë ndihmesën e saj për ta luftuar këtë dukuri negative.

Ne konsiderojmë se Ministria e Arsimit dhe shkollat duhet ta hartojnë një strategji për bashkëpunimin me prindërit, fëmijët dhe me nxënësit, të cilët dyshohen, dhe ata të cilët e konsumojnë drogën.

Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektorati Policor duhet në mënyrë sistematike të bëjnë kontrollimin e lokaleve, kafeneve rreth shkollave në kërkim të substancave narkotike.

Të zhvillohen fushata sistematike për parandalimin e përdorimit të drogave nga nxënësit. Këto fushata nuk duhet të kenë karakter vetëm vetëdijësues, por edhe ndërgjegjësues. Nga organet e sigurisë, të Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, gjykatat, kërkojmë të ndërmerren veprime konkrete penalizuese për të gjithë personat apo grupet kriminale, të cilat merren me shpërndarjen dhe shitjen e drogës.

Në fund, deputeti Salih Morina theksoi se LDK-ja kërkon angazhimin e Qeverisë dhe nismën konkrete për luftimin dhe largimin e dukurive të tilla negative nga shkollat tona.

**Afrim Kasolli**, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se fusha e arsimit në Kosovë, përfshirë të gjitha nivelet e organizmit të tij, ndodhet në krizë të gjithanshme, kjo tashmë nuk ka dyshim.



Në mungesë të vetëdijes themelore dhe konceptit të arsimimit, objektet shkollore sot janë shndërruar në vendndodhje të çdo veprimtarie tjetër, me përjashtim të idesë themelore që duhet ta kenë arsimimin dhe edukimin e brezave të ri.

Në vazhdim, ai tha se seria e dështimeve përfshin elemente që nga mungesa e infrastrukturës shkollore, e cila akoma është në gjendje jo të mirë dhe një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore nuk ofrojnë mjedis të shëndetshëm për nxënësit. Në mesin e tyre bëjnë pjesë edhe objektet e ndërtuara ose rinovuara në periudhën e pasluftës, të cilat janë dëmtuar si rezultat i mungesës së mirëmbajtjes.

Po ashtu, mungesa e mjeteve didaktike dhe teknologjisë arsimore ndikon në cilësinë e njohurive dhe shkathtësive që fitohen në shkollë. Në përgjithësi, shkollat në Kosovë nuk janë të pajisura në mënyrë adekuate me mjete didaktike, ndërsa teknologjia informative është në dispozicion vetëm të një numri të kufizuar shkollash dhe atë vetëm në formë të kabineteve të dedikuara për lëndë të veçanta.

Mirëpo, krahas këtyre dështimeve të gjithanshme, pa dyshim se një problem fundamental për arsimin në Kosovë paraqet edhe mungesa e sigurisë dhe veçanërisht në disa shkolla të mesme të larta, ndërsa prania e huliganizmit, mjeteve narkotike dhe sjelljeve të tjera të rrezikshme i bën disa shkolla e mjedise të pasigurta për nxënësit.

Ndërkaq, ajo që mund të konsiderohet edhe si shqetësim më serioz në këtë rast ka të bëjë me faktin se sipas këtyre të dhënave, trendi i përdorimit të këtyre substancave nëpër shkollat e Kosovës gjatë viteve të fundit ka shënuar rritje, fakt ky që paralajmëron se përhapja e narkomanisë dhe atë veçanërisht te të miturit përbën një kërcënim serioz për shoqërinë tonë gjatë viteve në vijim.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se në këtë drejtim duhet ndërmarrë disa hapa njëkohësisht për funksionalizimin e këtij interesi madhor kombëtar, hapa të cilët kanë të bëjnë me sigurimin e një infrastrukture cilësore dhe të shëndetshme, pajisjen e shkollave me mjete didaktike dhe teknologji mësimore e deri te riorganizimi i rrjetit të shkollave në Kosovë.

Në ato shkolla ku për çfarëdo arsye ekziston rreziku real për sigurinë e nxënësve do të duhej të sigurohet prania e organeve të rendit dhe të merren masa shtesë për parandalimin e situatave të padëshiruara. Si masa tjera duhet të jetë edhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve, kurse rol të veçantë në këtë drejtim do të kenë grupet këshilluese pedagogjike në nivel të komunës që duhet të punojnë me secilën shkollë veç e veç në hartimin e planit të zhvillimit profesional, si dhe mbikëqyrjen dhe realizimin e tij.

Grupi parlamentar që ai përfaqëson e konsideron të rëndësishëm edhe kontrollin mjekësor për të gjithë nxënësit e shkollave fillore një herë në muaj, apo të shkollave të mesme një herë në dy muaj, si masa të domosdoshme në mbrojtjen e shëndetit të kësaj kategorie të shoqërisë nga ky kërcënim shumë serioz, theksoi deputeti Afrim Kasolli.

**Daut Haradinaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se bashkëpunimi ndërmjet tri ministrive, Ministrisë së Arsimit, të Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk po funksionon dhe se kjo është adresa që duhet të merret me parandalimin dhe luftimin e drogave nëpër shkolla, ky është trekëndëshi që duhet të jetë jashtëzakonisht bashkëpunues për ta adresuar qartë dhe saktë këtë çështje. Duhet hequr logjikën se Policia është i vetmi institucion që duhet t'i ndalojë drogat nëpër shkolla.

Ministria e Arsimit duhet të ketë rol të rëndësishëm, e konkretisht trajnimin e mësimdhënësve për çështjen e drogave. Pastaj, organizimi i debatit dhe dialogu me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit është detyrë e Ministrisë së Arsimit. Bashkëpunimi me këshillat e nxënësve dhe këshillat e prindërve po ashtu është detyrë e Ministrisë së Arsimit, e kjo nuk po ndodh.

Në vazhdim, ai u fokusua në detyrat që duhet kryer secila nga tri ministritë e lartpërmendura në mënyrë që të arrihen rezultate sa më të mira në parandalimin dhe luftimin e përdorimit të substancave narkotike dhe dukurive tjera negative nëpër shkollat tona.

Duket që prej këtij trekëndëshi të institucioneve, e vetmja është Policia që mundohet t'i përmbushë obligimet e veta, megjithatë nuk është arritur shkalla e nevojshme e veprimeve policore për ta ndaluar transportin, shitjen, mbajtjen dhe përdorimin e drogave dhe konfiskimin.

Në fund, ai shfaqti bindjen se debati dhe rekomandimet e propozuara do ta marrin mbështetjen e deputetëve dhe do të ndihmojnë sadopak në luftimin e përdorimit të substancave narkotike dhe dukurive tjera negative.

**Jeton Svirca**, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se ky debat duhet të ngërthejë në vete edhe përgjegjësitë e tjera negative, të cilat janë në shoqërinë tonë, e posaçërisht ato të cilat kanë filluar të kenë një shtrirje te nxënësit, pra për drogën, alkoolin dhe duhanin.

Ne e përkrahim Ministrinë e Arsimit, konkretisht ministrin për veprimet të cilat i ka ndërmarrë në këtë drejtim, por ne konsiderojmë se për këto fenomene duhet një trajtim më gjithëpërfshirës.

Në vazhdim, ai theksoi se grupi parlamentar që ai përfaqëson jorastësisht, gjatë shqyrtimit të Ligjit për arsimin parauniversitar, kishin kërkuar që komponenti edukativ të shtohet në sistemin e arsimit si një faktor shumë i rëndësishëm për luftimin e këtyre dukurive, mirëpo ligji aktualisht e trajton vetëm komponentin arsimor.

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se në këtë mes duhet që Inspektorati të jetë më aktiv, gjithsesi Policia dhe Gjyqësori, dhe të marrin masa, në mënyrë që të tjerët të edukohen. Gjithashtu u bëjmë thirrje nxënësve që t'i lajmërojnë rastet, theksoi deputeti Jeton Svirca.

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re i japim mbështetjen tonë të plotë ministrit të Arsimit për të gjitha veprimet, të cilat i ka bërë dhe shpresojmë se edhe në të ardhmen do të ketë suksese në këtë drejtim, tha ai.

**Myfera Shidik**, në emër të Grupit Parlamentar "6+", tha se fatkeqësisht sot droga ka arritur edhe në oborret e shkollave, madje atë e përdorin edhe nxënësit e shkollave fillore.

Këtë dukuri nuk guxojnë ta anashkalojnë as mësuesit, as drejtorët e shkollave dhe as rrethi ku fëmijët jetojnë.

Grupi parlamentar që ajo përfaqëson do ta përkrahë në tërësi mocionin e paraqitur nga deputeti Burim Ramadani, ndërsa konstatoi se ne si shoqëri duhet që urgjentisht të ndërmarrim masa për të krijuar një rini të shëndoshë dhe një shoqëri të vetëdijshme në përgjithësi.

Diskutimet e deputetëve: Burim Ramadani, ministrit Ramë Buja, Idriz Vehapi, Sali Morina, Afrim Kasolli, Daut Haradinaj, Jeton Svirca dhe Myfera Shinik janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Fadil Demaku, Vjollca Krasniqi, Albana Gashi, Time Kadrijaj, Myzejene Selmani, Aurora Bakalli, Amir Ahmeti, Halit Krasniqi, Nazane Breca, Alma Lama, Teuta Haxhiu, Zenun Pajaziti, Hashim Dëshishku, Gëzim Kelmendi, Shaip Muja, Lirije Kajtazi, Behar Selimi, Ganimete Musliu dhe Ramiz Lladrovci** (diskutimin e dorëzoi me shkrim), diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Burim Ramadani i paraqiti rekomandimet e propozuara.

Kryesuesi më pas i hodhi në votim rekomandimet e propozuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i miratoi këto:

## **REKOMANDIME**

I. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë këto veprime:

1. Të organizojë trajnimin e mësimdhënësve në tërë Kosovën për fushën e drogave për secilin vit shkollor.
2. Të investojë në hulumtime mbi të cilat do të ndërtoheshin veprime, strategji dhe politika efektive.
3. Të bashkëpunojë ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat e profesionalizuara në këtë fushë.
4. Të ndërmerret një fushatë sensibilizuese me nxënësit për rreziqet e drogës dhe pasojat e përdorimit të saj në mentalitetin dhe edukimin e brezave.
5. Të ndërtohet Instituti Kombëtar për trajtimin e sëmundjeve të varshmërisë gjatë vitit 2014.

## **8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012**

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin e vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ai tha se edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar

Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Hashim Deshishku tha se diskutimin e tij për këtë pikë të rendit të ditës do ta dorëzojë me shkrim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012.

### **9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012**

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,  
Kundër ----- 7,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012.

### **10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në Mjedis**

Deputeti Liburn Aliu, raportues i Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se si komision e kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej, ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni Funkcional për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryesuesi Sabri Hamiti e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe Sevdije Lama, në emër të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e raportit me rekomandime të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

I. Miratohet raporti i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, me rekomandimet, si në vijim:

1. Qeveria dhe komunat ta zbatojnë legjislacionin në fuqi për VNM me gjithë mekanizmin përcjellës implementues (aktet nënligjore), në të gjitha projektet që kanë ndikim në mjedis.
2. Sektori i VNM pranë MMPH-së duhet t'i rrisë kapacitetet e resurseve humane në aspektin kuantitativ dhe kualitativ.
3. MMPH-ja duhet ta rrisë transparencën për procedurat e dhënies së pëlqimeve mjedisore dhe lejet që janë dhënë të jenë në dispozicion të publikut.
4. MMPH-ja duhet t'i licencojë personat fizikë dhe juridikë që i hartojnë raportet e VNM-ve dhe të njëjtit të bëhen publik për operatorët ekonomikë.
5. Të shtohet bashkëpunimi, si në rrafshin horizontal (ndërmjet dikastereve qeveritare dhe agjencive ekzekutive të pavarura), ashtu edhe në rrafshin vertikal (me komunat) në fushën e zbatimit të ligjit.
6. Të shtohet aktiviteti i Inspektoratit Mjedisor në mbikëqyrjen e implementimit të këtij ligji.
7. Komunat, gjatë dhënies së lejeve ndërtimore dhe të punës, t'i respektojnë pëlqimet mjedisore dhe planet e saj zhvillimore dhe urbane.
8. Të zbatohen dispozitat ligjore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe të organizohen fushata vetëdijesimi.
9. Të ndërpriten menjëherë të gjitha aktivitetet në zonat e mbrojtura që nuk janë pajisur me pëlqim mjedisor dhe lejet tjera përcjellëse.

## **11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor**

Deputeti Liburn Aliu, raportues i Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej, ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe Sevdije Lama, në emër të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit me rekomandime të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

### **V E N D I M**

I. Miratohet raporti i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, me rekomandimet, si në vijim:

1. Qeveria dhe komunat ta zbatojnë legjislacionin në fuqi për VSM, në të gjitha projektet që kanë ndikim në mjedis.
2. Komunat për planet zhvillimore të aplikojnë për pëlqim mjedisor, sipas ligjit.
3. MMPH-ja duhet ta rrisë transparencën për procedurat e dhënies së pëlqimeve mjedisore dhe lejet që janë dhënë të jenë në dispozicion të publikut.
4. Të shtohet bashkëpunimi, si në rrafshin horizontal (ndërmjet dikastereve qeveritare dhe agjencive ekzekutive të pavarura), ashtu edhe në rrafshin vertikal (me komunat) në fushën e zbatimit të ligjit.

5. Të zbatohen dispozitat ligjore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe të organizohen fushata vetëdijesimi.

## **12. Emërimi i dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, deputetja Xhevahire Izmaqi para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe arsyetoi rekomandimin për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Kryetari më pas i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës dhe me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, Kuvendi duhet t'i zgjedhë dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga katër (4) të propozuar, më votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, si në vijim:

- Prej dy (2) kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad hoc, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Kuvendi e zgjedh një (1) anëtar.
- Për pozitën e anëtarit nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë, prej dy (2) kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad hoc, Kuvendi e zgjedh një (1) anëtar.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sabri Hamiti, Emilija Rexhepi dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një Komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

1. G/P PDK - Halit Krasniqi,
2. G/P LDK - Hashim Dëshishku,
3. G/P "Vetëvendosje" - Albana Gashi,
4. G/P AAK - Teuta Haxhiu,
5. G/P - Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. G/P - SLS - Jasmina Zhivković,
7. G/P - "6+" - Fikrim Damka.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Halit Krasniqi.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 77 deputetë, ndërsa të pavlefshme ishin 25 fletëvotime.

Rezultati i votimit është si në vijim:

I. Për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar:

1. Murat Musliu ka fituar 34 vota dhe
2. Nysret Pllana ka fituar 13 vota

II. Për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë:

1. Elif Tokmak ka fituar 40 vota dhe
2. Elmaz Karadzi ka fituar 5 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Asnjëri nga kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar nuk i mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Bordit.
2. Radiotelevizioni i Kosovës duhet të bëjë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të RTK-së nga radha e komunitetit shumicë shqiptar, në pajtim me nenin 26.2 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Lidhur me propozimin për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë, Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

1. **Elif TOKMAK** zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë dhe joserb, me mandat tre (3) vjeçar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

\* \* \*

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*